



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR STAF AKADEMIK

Pozicioni: Lektor në Fakultetin e Ekonomisë. Ky pozicion është i hapur për personel akademik shqiptar dhe të huaj

Departamentet:

- Departamenti i Informatikës Ekonomike
- Departamenti i Shkencave Administrative
- Departamenti Financë-Bankë

Fusha specifike: Preferohet me titull akademik në fushat përkatëse të secilit departament (Financë, Kontabilitet, Administrim Biznesi, Informatikë Ekonomike, etj.)

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 05.07.2026

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është universitet i çertifikuar nga MAS i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT. Numri i përgjithshëm i studentëve në UMT është rreth 1000, numër i cili ka pësuar një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi e veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe SHBA. Një rëndësi e veçantë i është dhënë internacionalizimit të aktiviteteve pedagogjike nëpërmjet një sërë marrëveshesh me universitete evropiane dhe projektet Erasmus në mbështetje të mobiliteteve të studentëve. Gjithashtu po i jepet një rëndësi e veçantë nënshkrimit të marrëveshjeve me ndërmarrjet evropiane dhe vendase për mbështetjen e aktivitetit pedagogjik dhe shkencor si dhe punësimin e studentëve të UMT.

Përshkrimi i Pozicionit

Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) kërkon të angazhojë një Lektor me kohë të plotë në Fakultetin e Ekonomisë, për të mbështetur programet e studimit në fushën e ekonomisë, financës, menaxhimit dhe disiplinave të lidhura me biznesin.

Kandidati pritet të ofrojë mësimdhënie cilësore akademike, duke mbuluar temat kryesore të ekonomisë dhe aplikimin e tyre në kontekstin praktik të tregut dhe zhvillimeve bashkëkohore ekonomike. Gjithashtu, ai/ajo duhet të kontribuojë në zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive analitike të studentëve.

Kandidati ideal duhet të zotërojë një formim të fortë akademik dhe përvojë në mësimdhënie në

fusha kyçe si mikroekonomia, makroekonomia, financa, kontabiliteti, menaxhimi, ekonometria apo analiza e të dhënave ekonomike. Kërkohet aftësi për të lidhur teorinë me praktikën dhe për të përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies.

Ky pozicion ofron mundësinë për të kontribuar në formimin e profesionistëve të ardhshëm në ekonomi dhe biznes, përmes përmirësimit të kurrikulës dhe integritit të praktikave inovative në procesin e të nxënës.

Detyra dhe Përgjegjësitë

- ✓ Të njohë, të respektojë dhe të zbatojë legjislacionin dhe aktet e brendshme në fuqi;
- ✓ Të zbatojë statutin dhe rregulloret e institucionit;
- ✓ Të respektojë etikën dhe disiplinën akademike;
- ✓ Të zhvillojë leksione, seminare dhe aktivitete praktike sipas programit mësimor;
- ✓ Të hartojë dhe përditësojë syllabus-et në përputhje me standardet akademike;
- ✓ Të ofrojë konsultime dhe mbështetje akademike për studentët;
- ✓ Të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të studentëve (provime, detyra, projekte);
- ✓ Të kontribuojë në zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës;
- ✓ Të angazhohet në aktivitete kërkimore-shkencore dhe publikime;
- ✓ Të marrë pjesë në aktivitete akademike, trajnime dhe zhvillim profesional;
- ✓ Të kontribuojë në punën në grup brenda departamentit dhe fakultetit;
- ✓ Të përmbushë detyra administrative sipas nevojave të institucionit;
- ✓ T'i nënshtrohet vlerësimit të performancës akademike;
- ✓ Të raportojë në mënyrë periodike mbi aktivitetin akademik.

Kërkesat

Edukimi dhe Kualifikimet

- Minimumi gradë shkencore PhD në Ekonomi, Financë, Menaxhim ose fusha të ngjashme;
- Kandidatët në përfundim të doktoraturës inkurajohen të aplikojnë;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (minimumi niveli C1);
- Përvojë në mësimdhënie akademike ose trajnim profesional;
- Publikime shkencore në fushën e ekonomisë ose disiplinave të lidhura përbëjnë avantazh;
- Aftësi në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë në arsim;
- Përvojë në analiza ekonomike, studime tregu apo projekte kërkimore konsiderohet avantazh.

Aplikimi

Kandidatët konkurrentë duhet të dërgojnë në format elektronik këtë dokumentacion:

- Kërkesë me shkrim.
- CV (Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit “Master i Shkencave” si dhe dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë, ose vërtetim të ndjekjes së ciklit të tetë të studimeve “Doktoratë”. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MAS), ose vërtetim që janë në proces njohjeje.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al

